



## Herjola Spahiu

Drejtor i Përgjithshëm Ekzekutiv

Viti 2023, në vazhdimësinë e viteve të mëparshme, u karakterizua nga paqartësi ekonomike në tregjet ndërkontinentale dhe lokale, nën sforcimin për të rikthyer ekuilibrin ekonomik, rimëkëmbjen e ngadalta të ekonomive lokale në përpjekje për të zbuluar potenciale të reja, ndryshime të vazhdueshme të kuadrit rregullator, politika fiskale të rishikuara, mungesë e thelluar e forcës së punës dhe profesionistëve në çdo fushë.

Tashmë po mësohemi që çdo vit të përballemi me sfida të reja, të ndryshme nga ato të një viti më parë, dhe të ndërtojmë strategji të përshtatura dhe të ndryshueshme sipas nevojës së tregut, institucionit dhe sjelljes së konsumatorit. Për ne në NOA, të punuarit në mënyrë "të zhërvjellët" është bërë

shumë e nevojshme për të siguruar qëndrueshmëri të aktiviteteve nëpërmjet përshtatjes së shpejtë, si dhe një shërbim klienti në nivelet më të larta, në shenjë besnikërie për klientët tanë shumëvjeçarë.

Me gjithë pasiguritë e mësipërme, ne ja dolëm që t'i përbaheshim misionit tonë kryesor, mbështetjes financiare të ekonomisë lokale nëpërmjet financimit

të bizneseve të vogla dhe të mesme apo familjeve shqiptare në Shqipëri dhe Kosovë. Për më tepër, kemi zgjeruar aktivitetet këshilluese në terren apo nëpërmjet komunikimit digjital për klientët tanë fermerë dhe biznese të vogla. Konsoliduam më tej pozicionimin tonë si mbështetës i partnerëve tanë në të gjithë Shqipërinë, duke financuar shitjet e produkteve të tyre direkt në dyqan. Dhe sigurisht që ky vit kaq i rëndësishëm, që përbillylli edhe çerek shekull aktivitet të NOA-s në Shqipëri, u mbyll me inaugurimin e Degës Digitale të NOA-s, që në vetvete përfaqëson

kryerjen e procesit të kredidhënies në distancë nëpërmjet mjeteve të identifikimit digjital dhe firmës digjitale. Në përvjetorin e 25-të të Institucionit, arritjet financiare përfaqësojnë denjësisht përpjekjet dhe kontributin e vazhdueshëm të të gjithë punonjësve, besimin e lartë që na kanë dhënë klientët tanë apo partnerët financues në mbarë botën, mbështetjen e pamunguar të aksionerëve dhe bashkëpunëtorëve tanë lokalë. Portofoli i kredisë së Institucionit gjatë vitit 2023 u rrit me një ritëm prej 25% duke tejkualuar vlerën e 9 mld Lekë, nga të cilat 81% i janë akorduar klientëve të biznesit dhe 19% familjeve dhe individëve. Kjo shënon rritjen më të lartë të Institucionit në të gjithë historinë e tij, por gjithashtu edhe rritjen më të lartë kundrejt sistemit bankar dhe atij mikrofinanciar, të cilit, gjatë vitit 2023 realizuan një rritje prej rreth 5% dhe 12% përkatësisht.

16,854 klientët tanë aktivë u shërbyen nga 29 degët tona në qytetet kryesore të Shqipërisë, nga 333 punonjësit tanë profesionistë dhe të mirë trajnuar, të cilët përveç mbështetjes financiare, kujdesen që klienti të shëmangë mbi-financimin përtëj aftësive paguese. Një risi e rëndësishme e këtij viti është numri i klientëve të cilët kanë zgjedhur t'i marrin shërbimet tona financiare online, numër i cili është rritur me 34%. Tashmë konsumatori po drejton mënyrën se si ne po ofrojmë shërbimet tona, po zgjedh kanalin më të shpejtë të marres së këtij shërbimi, drejtohet ndaj produktit me dokumentacion të optimizuar dhe sigurisht që kërkon eksperiencën më të mirë në treg. Prandaj aftësia e shpejtë e përshtatjes duke ofruar shërbimet sipas kërkësës së tregut, na ka lejuar të rritemi me ritme të përhpejtuara sidomos në 3-vjeçarin e fundit.

Një rritje e tillë do të ishte e pamundur nëse nuk do të kishim pasur besimin dhe mbështetjen financiare të partnerëve tanë lokalë dhe ndërkontinentale. Një mbështetje e vazhdueshme, që i rezistoi sfidës së pandemisë, inflacionit dhe rritjes së normave të interesit, një mbështetje me një impakt të rëndësishëm social dhe ekonomik për vendin tonë. Gjatë vitit 2023 nënshkruam 6 milion euro marrëveshje me partnerë të rinj financiarë, si dhe ritëm ekspozimet aktuale me 19 milion euro me partnerë ekzistues.

Sigurisht, që ne nga ana tjetër i sigurojmë ata për përdorimin më të mirë të fondeve të tyre për klientët më në nevojë, në çdo sektor zhvillues të ekonomisë shqiptare, me praktikat më të mira të transparencës dhe duke respektuar gjithmonë çdo indikator cilësie të vendosur. Me qëllimin për të diversifikuar burimin e fondeve në LEK, në muajin Maj 2023, NOA gjithashtu hodhi në treg obligacionin e parë me ofertë publike

# Deklarata e Administratorit



në historinë e tregut të investimeve në Shqipëri, në shumën prej 500 mln Lekë, një ofertë e cila u realizua 100%. Rezultati finansiar i NOA-s, vazhdoi të jetë i qëndrueshëm edhe gjatë 2023, i ndikuar nga rritja e lartë e portofolit të kredisë, si dhe krijimi i eficencave të brendshme në kompani. Fitimi për vitin 2023 rezultoi me një rritje prej 6% kundrejt një viti më parë, në nivelin 421 mln Lekë pas tatimit. Vlen të theksohet që ky rezultat mund të ishte edhe më pozitiv nëse nuk do të ishte ndikimi negativ i rritjes së kostos së fondeve me rreth 1.5%, i ndikuar nga rritja e normës bazë të monedhës Euro. Nga ana tjeter, duke e konsideruar situatën ekonomike jo të favorshme për klientët tanë të vegjël, Institucioni ynë nuk e trasferoi këtë rritje të kostos së fondeve tek klientët tanë, ata vazhduan të paguanin të njëjtat këste kredie sikurse dakortësuar në lidhjen e kontratës.

Duke konsideruar natyrën e Institucionit, nuk kemi shpenzime në fushën e kërkimit dhe zhvillimit, duke qenë se ofrimi i shërbimeve dhe produkteve tona nuk kërkon projekte të mirëfillta të kësaj natyre.

Gjatë vitit 2023 nuk ka pasur ndryshime në strukturën aksionare të NOA sha, gjatë muajit Janar 2024 Banka e Shqipërisë ka aprovuar një ndryshim të kuotave të aksioneve mes aksionerëve fundorë të Institucionit, sipas publikimeve në Qendrën Kombëtare të Biznesit.

Në vijim, përsa i përket strategjisë për vitin 2024, NOA nuk parashikon ndryshime strukturelle në të ardhmen të cilat të ndryshojnë në mënyrë të rëndësishme formën, përbajtjen apo vizionin e saj mbi mënyrën sesi operon biznesin. Në lidhje me rritjen vazhdojmë të mbetemi pozitivë për potencialin e tregut të cilit ne i shërbejmë dhe do të vazhdojmë të zgjerojmë më tej aktivitetin tonë. Objektivat tona kryesore për 2024 do të janë:

- Vlera totale e aktiveve të kompanisë të arrije 13 mld Lekë, nga të cilat portofol i kredisë në nivelin 11.2 mld Lekë (+26%)
- Kredidhënia gjatë 2024 të tejkalojë 8 mld Lekë duke përfaqësuar një rritje vjetore prej 25%
- Numri i kredive të dhëna gjatë vitit të tejkalojë 22,000, dhe në fund të vitit numri i klientëve aktivë të arrije në 21,400
- Sigurisht që një nga objektivat e rëndësishme të institucionit është edhe mbajtja e cilësisë së portofolit në nivelet më të mira të tregut, gjë që nënkupton nivelin e kredive jo performuese (NPL) në nivelin 2.3%
- Fitimi neto i vitit pritet të ketë një rritje prej 10%, duke arritur vlerën prej 465 mln Lekë dhe duke mbajtur një kthim të qëndrueshëm nga kapitali prej 20%

Për arritjen e objektivave të mësipërme dhe në funksion të strategjisë së zgjerimit të biznesit, NOA ka vlerësuar dhe ka rregulluar nëpermjet politikave të brendshme manaxhimin e rreziqeve kryesore të parashikuara, sikurse rrezikun finansiar apo të likuiditetit, rrezikun e kredisë dhe të mjafueshmërisë së kapitalit. Aktualisht Institucioni ka arritur të plotësojë nevojat e likuiditetit për periudhën e ardhshme 12 mujore, duke nënshkruar apo premtuar nënshkrim me partnerë të ndryshëm, duke mbajtur të stabilizuar pozicionin neto për periudhën deri në një vit dhe një gjendje të likuiditetit më të lartë se 6% të totalit të aktiveve.

Gjithashtu, gjatë përgatitjes së strategjisë në fillim të vitit, janë vlerësuar nga Komiteti i ALCO-s luhatjet e pritshme të normave bazë të interesit, çmimin e kapitalit, luhatjet e kursit të këmbimit si dhe normat e kredisë në treg, duke propozuar gjithashtu masat përkatëse për të mbrojtur Institucionin ndaj këtyre rreziqeve.

Pjesë e pandarë e strategjisë së zhvillimit të biznesit është edhe strategjia e menaxhimit të rrezikut të kredisë, e cila parashikon të gjithë nivelet e kontrollit para dhe pas dhëties së kredisë në mënyrë që të mbahet një nivel i mirë i kostos së riskut të kredisë, sipas objektivave të vendosur. Në përputhje me kërkesat e Bankës së Shqipërisë, raporti i kapitalit rregulator me totalin e aktiveve nuk duhet të jetë më pak se 10%, ndërkohë që Institucioni ynë kishte një raport të kapitalit rregulator mbi totalin e aktiveve në nivel 17.3% më 31 Dhjetor 2023, i cili pritet të mbetet i qëndrushëm në 12 muajt e ardhshëm. Në përmbyllje, dua të falenderoj edhe njëherë bashkëpunëtorët tanë lokalë dhe ndërkombëtarë, klientët dhe stafin tonë të mrekullueshëm përmështetjen që na kanë dhënë në këto 25 vite, duke bërë të mundur arritjen e këtyre rezultateve të qëndrueshme.